

MANOUSSAKIS DHE TË TJERË kundër GREQISË

Në një vendim të dhënë më 26 shtator 1996 në lidhje me çështjen Manoussakis dhe të tjerë kundër Greqisë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mbajti qëndrimin se dënimi i dëshmitarëve të Jehovahut për hapjen dhe shërbimin të një shtëpie lutjesh pa autorizimin e Ministrit të Edukimit Kombëtar dhe të Kulteve dhe mosdhënia e autorizimit nga ana e këtij të fundit përbën shkelje të lirisë së tyre të besimit dhe të ushtrimit të kultit, pra të nenit 9 të Konventës.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Faktet kryesore

1. Banues në Kretë, Z. Titos Manoussakis, Z. Constantinos Makridakis, Z. Kyriakos Baxevanis dhe Z. Vassilios Hadjakis janë dëshmitarë të Jahovah-ut. Më 30 mars 1983, Z. Manoussakis merr me qera një sallë në Heraklion, me anë të një kontrate jo-noteriale të firmosur nga palët private, e cila vendos se salla do të përdoret për të gjitha llojet e mbledhjeve, martesave, etj., të krishterëve dëshmitarë të Jehovah-ut. Më 28 qershor 1983, kërkuesit i kërkojnë ministrit të edukimit kombëtar dhe të kulteve autorizimin për të përdorur këtë sallë si shtëpi lutjesh. Më 10 dhjetor 1984, ministria i informon se administrata po analizon kërkesën e tyre. Në këtë ditë procedura nuk kishte akoma mbaruar.

2. Më 3 mars 1986 prokurori i Heraklionit fillon ndjekjet penale kundër kërkuesve mbi bazën e Nenit 1 të ligjit n° 1363/1939, i ndryshuar nga Ligji nr. 1672/1939, për shkak të hapjes të një shtëpie lutjesh me qëllim për tu mbledhur dhe për të festuar ceremoni fetare të besimtarëve të rrëfimit të dëshmitarëve jehovah-ut (emri i Zotit të Biblës), pa autorizimin e autoriteteve fetare të njohura dhe të ministrit të edukimit kombëtar dhe të kulteve. Më 6 tetor 1987, gjykata penale e shkallës së parë i liron kërkuesit, duke vlerësuar se «mbledhja e besimtarëve të çfarëdo lloj doktrine, në mungesë të akteve të përhapjes së besimit (proselitizmit), është e lirë edhe në qoftë se ajo nuk është e autorizuar». Më 8 tetor 1987, prokurori i Heraklionit i kundërvihet këtij vendimi përpara të njëjtës gjykatë e mbledhur në apel, dhe fiton më 15 shkurt 1990 dënimin e secilit prej fajtorëve me tre muaj burgim i kthyesëm me 400 dhrahmi për ditë burgu dhe 20 000 dhrahmi gjobë. Të dënuarit paraqesin çështjen përpara Gjykatës së Kasacionit dhe mbrojnë faktin se Neni 1 i ligjit në fjalë dhe detyrimi për të kërkuar një autorizim për të hapur një shtëpi lutjesh (dekreti mbretëror i 20 majit dhe 2 qershorit 1939) bien në kundërshtim me Nenin 13 të Kushtetutës dhe Nenin 9 të konventës, të cilët garantojnë të drejtën për lirinë e fesë dhe të kultit. Gjykata e Kasacionit hedh poshtë kërkesën e tyre më më 19 mars 1991.

B. Procedurat përpara Komisionit European të të Drejtave të Njeriut

3. Në kërkesën e tyre të 7 gushtit 1991 drejtuar Komisionit, të interesuarit bazohen mbi Nenin 3, 5, 6, të ndërthurur me Nenin 8, 9, 10, 11 dhe 14 të Konventës dhe 1 të protokollin nr. 1.

4. Më 10 tetor 1994, Komisioni mbështet padinë përta i përket ankesës së bazuar mbi Nenin 9. Në raportin e 25 majit 1995, ajo vendos se Neni 9 është shkelur. (me unanimitet).

II. PËRMBLEDHJE E VENDIMIT TË 26 SHTATORIT 1996 (dhomë) (përmbledhje 1996-IV)

A. Në lidhje me pretendimet paraprake

5. Qeveria mbështet në rradhë të parë faktin se kërkuesit nuk i kishin shfrytëzuar të gjitha rrugët e brendshme të rekursit, duke u ankuar dy herë rrjesht përpara Këshillit të Shtetit për refuzimin e heshtur nga ana e ministrit të edukimit kombëtar dhe të kulteve për autorizimin e kërkuar. Por heshtja e ministrit në krye të tre muajve është e barabartë me një refuzim të heshtur, i cili mund të kundërshtohet përpara Këshillit të Shtetit për tejkalim kompetencash.

Në rekursin e tyre në Kasacion, kërkuesit mbështeteshin kryesisht mbi papajtueshmërinë e Nenit 1 të Ligjit nr. 1363/1938, i cili kishte shërbyer si bazë për dënimin e tyre, së bashku me Nenin 9 të Konventës dhe 13 të Kushtetutës. Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë këtë ankesë duke gjykuar se Gjykata Penale e Heraklionit e mbledhur në apel kishte interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat e lartpërmendura. Kërkuesit kanë shfrytëzuar rrugët e brendshme të rekursit lidhur me dënimin e tyre.

6. Përsa i përket kërkesave të autorizimit, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe të kulteve iu është përgjigjur pesë herë me shkrim se ai po hetonte çështjen. Asnjëherë nuk ka patur as vendim të heshtur që vendoste një afat rekursi, as vendim të qartë nga ana e administratës dhe kërkuesit kanë qënë në pritje që prej 18 tetorit 1983. Por një dyshim në lidhje me datën e fillimit të afateve të parashikuara mund të ekzistonte mendjen e kërkuesve : pas kërkesës së dytë të autorizimit të interesuarve, më 18 tetor 1983, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe i kulteve iu përgjigj të interesuarve më 25 nëntor 1983, pra përpara skadimit të tre muajve që ndoqën bërjen e kërkesës ; pra nuk ka heshtje të administratës të barabartë me një refuzim të heshtur të autorizimit të kërkuar.

Gjykata hedh poshtë këtë pretendim. *(me unanimitet).*

B. Në lidhje me themelin

7. Në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata konstaton se dënimi i të interesuarve i vendosur prej gjykatës penale të Heraklionit e thirrur në apel për faktin se të interesuarit kanë përdorur sallën e marrë me qera pa autorizimin e parashikuar nga Ligji nr. 1363/1938, paraqet një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tyre për «lirinë e ushtrimit të fesë së tyre me anë të kultit dhe riteve».

8. Në lidhje me justifikimin e ndërhyrjes, Gjykata vë re se kërkuesit ankohen më pak për trajtimin, pengimin që iu bëhet kur ata dëshirojnë të hapin një kishë apo një vend kulti; pra ata sulmojnë në thelb dispozitat e legjislacionit të brendshëm. Megjithatë, Gjykata nuk e mendon të nevojshme të kërkojë në qoftë se ndërhyrja ishte «e parashikuar nga ligji» apo jo, sepse sido që të ndodhë, ndërhyrja në fjalë është në kundërshtim me Nenin 9 përsa i përket pikëpamjeve të tjera.

Shtetet kanë pushtetin e kontrollit në qoftë se një shoqatë duke patur qëllime fetare, kryen aktivitete që dëmtojnë qytetarët. Megjithatë rrëfimi i dëshmitarëve të jehovah-ut, i përmbush sipas ligjit grek kushtet e një kishe « të njohur ». Por duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, Gjykata konsideron se dënimi i tyre ndiqte një qëllim legjitim në përputhje me Nenin 9 § 2 të Konventës : mbrojtja e rregullit.

10. A ishte kjo masë e nevojshme në një shoqëri demokratike? Legjislacioni grek

lejon një ndërhyrje të thellë të autoriteteve politike, administrative dhe fetare në ushtrimin e lirisë fetare. Kushteve të shumta të parashikuara nga ligji, që disa prej tyre i japin policisë, kryetarit të bashkisë, dhe të komunës një pushtet të madh vlerësimi, iu shtohet mundësia e dhënë Ministrisë të Edukimit Kombëtar dhe të kulteve për të shtyrë deri në pafundësi përgjigjen e tij ose për të refuzuar autorizimin pa shpjegime apo arsye të vlefshme.

11. E drejta për lirinë e fesë ashtu sikurse e koncepton Konventa përjashton çdo vlerësim nga ana e Shtetit të legjitimitetit të besimeve fetare ose të mënyrave të shprehjes së tyre? Duke u bazuar mbi këtë, Gjykata vlerëson se sistemi i autorizimit shkon me Nenin 9 vetëm kur ai ka për qëllim të sigurojë një kontroll të Ministrisë mbi respektimin e kushteve formale.

Por, nga dosja del si dhe nga shumë raste të raportuara nga kërkuesit dhe të pakundërshtuara nga qeveria, shteti tenton të përfitojë nga fuqia e legjislacionit në mënyrë që të imponojë kushte të rrepta dhe që ndalojnë ushtrimin e disa kulteve jo ortodokse, sidomos atë të dëshmitarëve të Jehovahut.

Në rastin tonë, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe i kulteve, i pyetur pesë herë nga kërkuesit, nga 25 tetori 1983 deri më 10 dhjetor 1984, u përgjigj se ai po analizonte dosjen e tyre. Kërkuesit nuk morën një përgjigje të shprehur qartë. Në këto kushte qeveria nuk mund të mbështetej mbi moszbatimin e një formaliteti ligjor nga kërkuesit për të justifikuar dënimin e tyre. Në këtë kuadër masa e dënimit nuk ka asnjë rëndësi.

12. Gjykata vendos se dënimi i kundërshtuar prek kaq direkt lirinë fetare të kërkuesve, aq sa ai nuk mund të vihet në barazpeshim me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe të nevojshëm në një shoqëri demokratike. Pra Neni 9 është shkelur. *(me unanimitet)*

C. Në lidhje me nenin 50 të Konventës

13. Në fushën e Nenit 50, Gjykata konsideron se të interesuarit kanë pësuar një dëm moral, por konstatimi i shkeljes së Nenit 9 mjafton për t'i shpërblyer (me unanimitet).

Për shpenzimet përpara autoriteteve greke dhe të Strasburgut, të interesuarit kërkonin një shumë prej 4 030 100 dhrahmish, të paraqitura hollësisht në kërkesë. Gjykata e vlerëson këtë kërkesë të arsyeshme dhe e mbështet në tërësi.